

2019-2020

MICS në Republikën e Kosovës

dhe

MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës

Martestat e fëmijëve

MICS


Anketa e Treguesve të Shumëfishtë



Martestat e fëmijëve tek femrat dhe meshkujt


Martesa para moshës 15 dhe 18 tek femrat (SDG 5.3.1**) dhe meshkujt

Kosovë



Përqindja e femrave dhe meshkujve të moshës 20-24 vjeç të cilët për herë të parë janë martuar apo kanë hyrë në bashkëjetesë para moshës 15 vjeç dhe 18 vjeç

Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë



Përqindja e femrave dhe meshkujve të moshës 20-24 vjeç të cilët për herë të parë janë martuar apo kanë hyrë në bashkëjetesë para moshës 15 vjeç dhe 18 vjeç

Grafikët e mësipërm u referohen femrave dhe meshkujve të moshës 20 deri 24 vjeç, pasi kjo grupmoshë e të rinjve kanë përfunduar së fundmi rrezikun e ekspozimit të martesës në fëmijëri, duke dhënë kështu një vlerësim më të përafërt të prevalencës aktuale të martesave të fëmijëve. Grafikët e mëposhtëm, të cilët tregojnë zbrëthimin sipas karakteristikave të përgjithshme, u referohen të gjitha grupmoshave të femrave dhe meshkujve të moshës 20 deri 49 vjeç.


**Treguesi 5.3.1 i SDG-ve i referohet vetëm prevalencës së martesave të fëmijëve tek vajzat: Përqindja e femrave të moshës 20-24 vjeçe që ishin martuar ose në bashkëjetesë para moshës 15 vjeçe dhe para moshës 18 vjeçe.

Mesazhet kryesore

- 1 në 25 femra dhe 1 në 50 meshkuj të moshës 20–24 vjeç ishin martuar para moshës 18 vjeç në Kosovë. Përqindja është shumë më e lartë tek femrat dhe meshkujt të kësaj moshe që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë: 1 në 3 femra dhe 1 në 10 meshkuj të moshës 20-24 vjeç ishin martuar para moshës 18 vjeçe.
- Martesa para moshës 18 vjeç është më e zakonshme në mesin e femrave të moshës 20–49 vjeç pa edukim (41 për qind e femrave në popullatën e përgjithshme dhe 47 për qind e femrave që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian ishin martuar para moshës 18 vjeç), krahasuar me ato me nivel më të lartë të edukimit (1 për qind dhe 10 për qind, përkatësisht). Një trend i ngjashëm vërehet nga pasuria e ekonomive familjes, me femrat që jetojnë në ekonomi familje më të varfra kanë më shumë të ngjarë të martohen para moshës 18 vjeç sesa ato që jetojnë në ekonomi familjet më të pasura.
- Në popullatën e përgjithshme, martesa para moshës 18 vjeçe ka rënë pak me kalimin e kohës, nga 13 për qind tek femrat të moshës 45-49 vjeç në 4 për qind tek ata të moshës 20-24 vjeç.
- Një trend negativ me kalimin e kohës në martesë para moshës 18 vjeçe është gjithashtu i dukshëm tek meshkujt që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, ku 20 për qind e meshkujve në grupmoshën 45-49 vjeç ishin martuar para moshës 18 vjeç krahasuar me 10 për qind të meshkujve në grupmosha 20–24 vjeç.

Zbërthimet në martesë para moshës 18 vjeç

Kosovë




Përqindja e femrave dhe meshkujve të moshës 20-49 vjeç të cilët për herë të parë janë martuar apo kanë hyrë në bashkëjetesë para moshës 18 vjeç, sipas vendbanimit, arsimit dhe kuartilëve të pasurisë

() Shifrat që bazohen në 25-49 raste të papeshuara

(*) Shifrat që bazohen në më pak se 25 raste të papeshuara

Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë



Përqindja e femrave dhe meshkujve të moshës 20-49 vjeç të cilët për herë të parë janë martuar apo kanë hyrë në bashkëjetesë para moshës 18 vjeç, sipas vendbanimit, arsimit dhe kuartilëve të pasurisë


() Shifrat që bazohen në 25-49 raste të papeshuara

(R) Indeksi i pasurisë është ndërtuar duke përdorur informacionin mbi asetet e ekonomive familjare me supozimin se kjo reflekton pasurinë afatgjatë, duke i renditur ekonomitë familjare sipas pasurisë, nga më të varfërat te ato më të pasurat. Llogaritjet janë kryer veçmas në mostrën për MICS për Kosovë dhe mostrën për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në MICS për Kosovën, duke përdorur karakteristikat për secilën mostër përkatëse. Rezultatet e llogaritura të pasurisë pra janë të zbatueshme vetëm për të dhënat e veçanta në të cilat bazohen dhe ndryshojnë për dy anketat. Gjetjet sipas rezultateve të pasurisë të llogaritura për MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian tregohen me '(R)' në grafikon.


Trendet në martesë të fëmijëve

Kosovë

Femrat



Meshkujt




Përqindja e grave (majtas) dhe burrave (djathtas) të moshës 20-49 vjeç të cilët për herë të parë janë martuar apo kanë hyrë në bashkëjetesë para moshës 15 vjeç dhe 18 vjeç, sipas grupmoshës


Martesa para moshës 18 vjeçe është një realitet për shumë vajza të reja. Në shumë pjesë të botës prindërit inkurajojnë martesën e vajzave të tyre që në fëmijërinë e hershme me shpresë se martesë do t'i sjellë përfitime financiare dhe shoqërore, duke lehtësuar gjithashtu barrën financiare mbi familjen. Në fakt, martesë e fëmijëve është një shkelje e të drejtave të njeriut, duke komprometuar zhvillimin e vajzave dhe që shpesh rezultojnë në shtatzëni të hershme dhe izolim shoqëror, me pak arsim dhe trajnim të dobët profesional që forcon natyrën gjinore të varfërisë. E drejta për pëlqim 'të lirë dhe të plotë' për një martesë njihet në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut - me njohjen që pëlqimi nuk mund të jetë 'i lirë dhe i plotë' kur njëra nga palët e përfshira nuk është mjaft i/e pjekur për të marrë një vendim të informuar në lidhje me partnerin/en e jetës.

Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë

Femrat



Meshkujt



Përqindja e femrave (majtas) dhe meshkujve (djathtas) të moshës 20-49 vjeç të cilët për herë të parë janë martuar apo kanë hyrë në bashkëjetesë para moshës 15 vjeç dhe 18 vjeç, sipas grupmoshës

Anketa e Treguesve të Shumëfishtë për Kosovë (MICS) dhe MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë janë realizuar në 2019-2020 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) si pjesë e programit global MICS. Mbështetja teknike u siguroi nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF), me fonde të siguruar nga Ministria e Financave (MF), Qeveria e Luksemburgut, Fondacioni i Mijëvjeçarit në Kosovë (MFK), UNICEF, Ekipi i Kombeve të Bashkuara të Kosovës (UNKT), Fondi i Popullsisë i Kombeve të Bashkuara

(UNFPA) dhe UN Women. Qëllimi i kësaj pasqyre të shkurtër informative është shpërndarja e gjetjeve të zgjedhura nga MICS 2019-2020 në Kosovë dhe MICS 2019-2020 me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë në lidhje me martesën e fëmijëve. Të dhënat nga kjo pasqyrë e shkurtër informative mund të gjenden në tabelat PR.4.1W dhe PR.4.1M në Raportin e Gjetjeve të Anketës (treguar me shkronjën 'R' për MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë).

Pasqyrat tjera të shkurtra informative statistikore dhe Raporti i Gjetjeve të Anketës për këtë anketë dhe anketa të tjera janë në dispozicion në mics.unicef.org/surveys.